



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1704/1 Prot.

Tiranë, më 16.12. 2025

V E N D I M

Nr. 295, datë 16 . 12. 2025

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 306 regj, datë 4.12.2025, të paraqitur nga ankuesi A.P kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Akademisë së Sigurisë, Tiranë, me pretendimin se është diskriminuar në kuadër të *çdo shkak tjetër*. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi A.P parashtroi si vijon:

“Unë, A.P, student i diplomuar në degën e mjekësisë, me mesatare ekselence 8.8, paraqes pranë jush këtë ankesë lidhur me përjashtimin tim nga procesi i pranimit në Fakultetin e Akademisë së Sigurisë dhe dyshimet e mia për trajtim të pabarabartë dhe në kundërshtim me standardet e transparencës dhe mosdiskriminimit.

Në shtator 2025, pas plotësimit të të gjitha kriterëve të pranimit, përfshirë dokumentacionin, testet fizike dhe psikologjike, mora nga Komisioni i Akademisë së Sigurisë njoftimin verbal se isha pranuar në shkollë.

Unë shkova u regjistrova në shkollë, më pas mora uniformën, u betova dhe firmosa kontratën.

Më datë 25 nëntor 2025 u njoftova papritur për përjashtimin tim “me efekt të menjëhershëm”, bazuar në një shkresë të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme, por si dekan i dhe rektori nuk më dhanë asnjë arsye. Urdhri i përgjigjeve një shkresë të ardhur në akademi më datë 20 nëntor 2025.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Më pas më 21.11.2025 jam përjashtuar me efekt të menjëhershëm me pretendimin “Mosplotësim i kriterëve të besueshmërisë dhe integritetit” që do të thotë besueshmëria që vjen nga komisaritet e vendbanimeve ku ne jetojmë ishte negative. Kur ishte negative, si u lejova të hyja në shkollë, duke qenë se kjo kishte ndodhur që në muajin gusht? Përse Akademia nuk më tregon arsyen përse dërgoi shkresë negative te Drejtoria e Përgjithshme.

Kam kërkuar sqarime, por nuk më është kthyer asnjë përgjigje zyrtare mbi bazën e të dhënave të përdorura.

Deri më sot, nuk kam asnjë vepër penale, asnjë precedent, dhe jam i pajisur me dëshminë e penalitetit të pastër lëshuar nga e-albania.

Kam qenë tri herë i shoqëruar në polici për sqarime të konflikteve verbale, të lidhura me biznesin e vogël të familjes, pa asnjë akuzë të ngritur dhe pa asnjë procedim penal.

Nuk kam asnjë informacion se përse rezultati im është cilësuar si “negative”, as mbi bazën e cilave të dhëna është marrë vendimi për përjashtim. Pavarësisht kësaj, jam përjashtuar pa transparencë dhe pa të drejtë mbrojtje, ndonëse kisha përmbushur të gjitha kriteret dhe isha pranuar zyrtarisht më parë.

Bazuar në mënyrën se si është trajtuar çështja ime, ngre dyshime për:

- *Mungesë transparence në procesin e verifikimit të “besueshmërisë dhe integritetit”.*
- *Trajtim të pabarabartë, pasi fillimisht jam pajisur me uniformë dhe kontratë, dhe më pas jam përjashtuar pa argumentim.*
- *Vlerësim të mundshëm subjektiv ose të pabazuar nga strukturat përkatëse, i cili ka prekur drejtpërdrejt të drejtën time për arsim dhe punësim.*
- *Cenim të dinjitetit tim, pasi jam etiketuar si “i pabesueshëm” pa asnjë provë dhe pa të drejtë mbrojtje.*

Këto rrethana më bëjnë të ndjej se vendimi i marrë mund të jetë diskriminues dhe jo në përputhje me standardet ligjore të procesit të drejtë dhe të paanshëm.

Konsideroj se ndaj meje është ushtruar diskriminim në kuptim të nenit 1 dhe 3 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili ndalon çdo formë trajtimi të pabarabartë jo vetëm për shkak të kategorive të listuara, por edhe për “çdo shkak tjetër”, “statusi ose çdo karakteristike tjetër”

Vlerësimi negativ i besueshmërisë mbi “statusin” tim ka çuar në përjashtimin tim pa bazë ligjore dhe cenimin e të drejtës për arsim dhe punësim.

Kjo përbën një formë diskriminimi të ndaluar nga neni 1 dhe neni 3, i ligjit, duke më vendosur në kushte të më pak të favorshme se kandidatët e tjerë, pa arsye objektive dhe të provuar.”

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri :

- Të hetojë procedurën e ndjekur nga Akademia e Sigurisë dhe Drejtoria e Përgjithshme në vlerësimin e besueshmërisë time.
- Të verifikojë nëse ka pasur diskriminim, trajtim të pabarabartë apo shkelje të së drejtës time për transparencë dhe proces të rregullt administrativ.
- Të kërkojë sqarim të plotë dhe dokumentim nga institucionet përkatëse mbi bazën e të dhënave që kanë çuar në vlerësimin negativ.
- Të rekomandojë marrjen e masave korrigjuese, nëse vërtetohet diskriminim, përfshirë rikthimin në procesin e pranimit ose rivlerësimin e çështjes.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: **“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”**

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Sipas nenit 5, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim,

sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Nëpërmjet *e-mailit* të datës 12.12.2025, ankuesi paraqiti një kërkesë me shkrim nëpërmjet të cilës deklaroi se heq dorë nga shqyrtimi i ankesës.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar përcaktohet: “3. *Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.*”

Në nenin 90, “*Përfundimi i procedurës administrative*”, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, sanksionohet se: “3. *Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrative.*”. Ndërsa, në nenin 94 “*Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës*”, pikat 1 dhe 3, të Kodit të procedurave Administrative, parashikohet si vijon: “1. *Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.3. Në çdo rast, tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës nuk ndikon në vazhdimin e tij, nëse organi publik çmon se vazhdimi i procedurës është në interes publik, me përjashtim të rasteve kur procedura është e tillë që mund të fillojë vetëm me kërkesën e pales.*

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesi në datën 12.12.2025, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës Nr. 306 regj, datë 4.12.2025, të paraqitur nga ankuesi A.P kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Akademisë së Sigurisë, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a” dhe pika 2, nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, nenin 90, pika 3 dhe nenin 94, pikat 1 dhe 3, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar pa një vendim përfundimtar, procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.306 Regjistri, datë 04.12.2025, paraqitur nga ankuesi A.P kundër

Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Akademisë së Sigurisë, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: çdo shkak tjetër

Fusha: Arsim

Lloji i vendimit: Tërheqje